

Why was the Istanbul alphabet abandoned?

Abstract: *In this article the author examines carefully three canonical variants of the Istanbul Alphabet of Albanian. Such an approach has made it possible for him to realise its unquestionable Latin origin. In fact, its Latin letters make up about two-thirds of it. This was not the result of an accident, but a deliberate choice of its authors, particularly Sami Frashëri. Consequently, the author concludes that the 'oriental character' attributed to it by its opponents is, in fact, an undeserved stigma.*

Furthermore, author Doka has had the opportunity to observe that its solutions, despite the technical difficulties they presented in printing, were scientifically correct. In its canonical variants, there is an absence of fluctuations or polyvalence in the graphemes used.

Regarding the reasons for its abandonment, Doka believes that, besides technical issues, human vanity and the pressure exerted by the Young Turks played a significant role. In actual fact, immediately after the Congress of Manastir, they began attempting to impose the Turkish-Arabic alphabet on the Albanians.

Keyword: *Istanbul Alphabet, Canonical Variant, Literary and Cultural Circle, Latin Letters, Greek Letters, Slavic Letters.*

Si produkti në kompromisi që nga njëra anë synonte t'u jepte shqiptarëve një alfabet funksional, sipas parimit «për çdo zë të vetëm e të pandarë një shkronjë të vetme», ndërsa, nga ana tjetër, rrekej të tregonte veçantinë e tyre si popull, por edhe t'i ruante ekuilibrat e brishtë të afiniteteve të tyre kulturore, fetare dhe politike, alfabeti 36-shkronjesh i Stambollit, nga i cili kemi tri variante kanonike¹, që “i dënuar” të ishte i përzier. Këto variante janë:

1. a, b, c, ç, d, ð, e, f, g, h, i, j, k, l, λ, m, n, ñ, o, p, q, r, s, ɐ, t, ð, u, v, x, y, z, ʒ²

1 Ne bëjmë dallimin mes varianteve kanonike, të cilat kishin njëfarë autoriteti e qëndrueshmërie e që synonin përmirësimin e alfabetit të Stambollit, dhe varianteve jokanonike, që u shfaqën rastësisht, për shkak të problemeve teknike në shtypshkrim dhe, për këtë arsye, ishin efemere. (A. D.).

2 Varianti më i vjetër i alfabetit të Stambollit, me shkronjat e vogla dhe të mëdha të

A, B, C, Ç, D, Δ, E, E, F, G, Γ, H, I, J, K, L, Λ, M, N, Η, O, Π, Q, R, P, S, Σ, T, Θ, U, V, X, X, Y, Z, 3.

2. a, b, c, ç, d, ð, ε, e, f, g, f, h, i, j, k, l, λ, m, n, η, o, p, q, r, p, s, ε, t, ð, u, v, x, x, y, z, z.³

A, B, C, Ç, D, B, E, E, E, F, G, Γ, H, I, J, K, L, Λ, M, N, Η, O, Π, Q, R, P, S, C, T, Θ, U, V, X, X, Y, Z, Z.

3. a, b, c, ç, d, ð, ε, e, f, g, f, h, i, j, k, l, λ, m, n, η, o, p, q, r, p, s, ε, t, ð, u, v, x, x, y, z, z.⁴

A, B, C, Ç, D, B, E, E, E, F, G, Γ, H, I, J, K, L, Λ, M, N, Η, O, Π, Q, R, P, S, C, T, Θ, U, V, X, X, Y, Z, Z.

Nga paraqitja e mësipërme shihet se dy variantet e para kanonike ndryshojnë pak prej njëri-tjetrit në radhën e shkronjave të vogla të shtypit, gjegjësisht për ç ≠ ç, f ≠ g dhe z ≠ z. Hendeku thellohet në radhën e shkronjave të mëdha të shtypit, ku variantet dallohen në 6 shkronja □ ≠ Ç, Δ ≠ B, E ≠ E, E ≠ E, Σ ≠ Θ dhe 3 ≠ Z.

Bazën latine të këtij alfabeti Sami Frashëri e shpjegon me atë që «Shqipëria është një copë vënt nga Evropa, edhe shqiptarët janë një nga kombet’ e Evropësë; p’andaj edhe gjuha shqip duhet shkruar me shkronjat

shtypit, me të cilin është botuar *Kanonizma* e Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip dhe *Alfabetarja e gjuhës shqip*. E kemi nxjerrë nga fotogaleria e artikullit të Myzejen Myftarit, *Kjo është alfabetarja e gjuhës shqipe, dhuruar sulltan Abdyl Hamitit II më 1879*, 23 nëntor, 2019, <https://www.gazetatema.net>. Tek tabela e alfabetit të *Alfabetares* ε-ja e ka këmbyer vendin me e-në, ndërsa E-ja me E-në, por teksti i saj dëshmon se ato nuk i kanë këmbyer vlerat, prandaj ne e ndreqëm renditjen e shkronjave. (A. D.).

- 3 Varianti më i njohur i alfabetit të Stambollit, me shkronjat e vogla dhe të mëdha të shtypit, me të cilin është botuar nga viti 1897 deri në vitin 1908 “Kalendari Kombiar”. Radhën e shkronjave të vogla e kemi nxjerrë nga faksimilja e botuar prej Mahir Domit tek *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit (14-22 nëntor 1908)*, në A. BUDA, M. DOMI (eds.), *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë – Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1972, 23. Radhën e shkronjave të mëdha e kemi rindërtuar sipas “Kalendarit Kombiar” të vitit 1899. (A. D.).
- 4 Varianti i alfabetit të Stambollit me shkronjat e vogla dhe të mëdha të shtypit, i miratuar në Kongresin e Manastirit, me të cilin u botua “Diturija” e Lumo Skëndos, që prej vitit 1909 deri në qershor të vitit 1916. Radhën e shkronjave të vogla e kemi rindërtuar nga faksimilja e Vendimit të Komisionit për Çështjen e Abece-së, botuar prej Mahir Domit tek *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit...*, në A. BUDA, M. DOMI (eds.), *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, 38. Siç mund të shihet, në faksimilen e Vendimit renditja e shkronjave është paksa e ndryshme nga ajo që përdorim sot. Vargu i tyre mbyllet me x (xh). Radhën e shkronjave të mëdha e kemi rindërtuar nga “Diturija” e vitit 1909. (A. D.).

e Evropësë, do-me-thënë me shkronjatë llatinishte.»⁵

Duke dashur ta përligjë zgjedhjen e bërë për mospërfshirjen e dyshkronjëshave, por edhe ta sqarojë, si dalzotës⁶, përbërjen e alfabetit, Samiu shkruan tek *Alfabetarja e gluhësë shqip*: «Vërtet shkronjat’ e llatinishtesë janë aqë të paka, sa jo për gjuhët tënë, që ka kaqë zërra, po edhe për gjuhërat e Evropësë nukë janë mjaft. Evropianët për të mbushurë ato të pakatë, shkruajnë nga dy shkronja, e i këndojnë të dyja bashkë, po kjo është një pun’ e rëndë e e mërzturë. Kësaj i desh gjëndurë një udhë. Përmi këtë shumë njerëz janë menduarë edhe shumë udhëra kanë gjeturë, po nonjë nukë ka qën’ e lehtë’ e e pëlqyerë sikundrë duhetë. Këtë herë që u duk nevoj’ e madhe për të shkruarët të gjuhësë sanë, këtë her’ u gjënt edhe një udhë shumë e lehtë’ edhe shumë’ e mirë: Muarmë të njëzet e pesë shkronjatë llatinishte, u dhamë cave nga ato një këndim pas nevojës së gjuhësë sanë, edhe nga të njëmbëdhjetat’ e tjera ca i bëmë prapë nga ato shkronja, duke ndërruarë pak fytyrënë, ca i muarmë nga greqishtja, që është’ edhe ajo një nga motërat’ e vjetëra të gjuhësë sanë, si edhe llatinishtja.»⁷

Ndjekja e njëmendët e parimit “për çdo tingull të veçantë një shkronjë të vetme”, do të na i kishte kursyer andrallat e takimeve të dy bashkëtingëlloreve që përbëjnë edhe digrame e, për këtë arsye, mund të lexohen edhe ndryshe. E kemi fjalën për të ashtuquajturat nekse të tipit *g-j*, *n-j*, *s-h*, *t-h*, si te *lag-ja* (lagia me vlerë emërore, por lagja me vlerë foljore), *shmang-ja* (shmangia me vlerë emërore, por shmangja me vlerë foljore); *rën-ja* (rënia), *ngrën-ja*

5 Cituar sipas Rami Memushajt, tek *Alfabeti i Shoqërisë së Stambollit në dritën e shtypit të Rilindjes*, 21 tetor, 2022, <https://sot.com.al>.

6 Ndonëse përgjithësisht çmohet si fryt i punës së të gjithë komisionit, me Sami Frashërin kryetar, Jani Vreton, Pashko Vasën dhe Hasan Tahsinin anëtarë, alfabeti i Stambollit që në thelb vepër e dy njerëzve: Jani Vretos dhe Sami Frashërit; madje, i pari, në letërkëmbimin e vet, nuk ka ngurruar ta quajë “alfabeti im”. Alfabet të Vretos e ka quajtur edhe Kristoforidhi, veçmas kur i duhej ta kritikonte. Jani Vretos i njihet merita “e projektit fillestar” [edhe pse në asnjërin prej procesverbaleve të njohura për mbledhjet e komisionit nuk shkruhet që e pruri ai], dhe se këmbënguli fort në ndjekjen e parimit “për çdo tingull, një shkronjë”. Po ashtu, atij i njihet edhe e meta që, si grekocentrist, u rrek të përdorte shumë germa greke për shkrimin e shqipes. Samiut, në anën tjetër, lypset t’i njohim meritën që e thjeshtoi “projektin e Vretos” dhe e afroi me alfabetin latin. Për këtë arsye, bashkëkohës dhe studiues të mëvonshëm kanë vënë në dukje se, pa ndihmesën e Sami Frashërit, “projekti i Vretos” do të kishte mbetur një eksperiment shkrimor i papërdorshëm. Kjo, me sa duket, i ka shtyrë disa të tjerë ta mbajnë Samiun si arkitektin e vërtetë të alfabetit dhe ta quajnë atë alfabeti i Samiut, ose i Frashërlinjeve. Megjithatë, nuk mund të mos ia njohim Vretos meritën e veçantë që pati në përhapjen e këtij alfabeti, përmes botimeve që bëri në Bukuresht. Të bën përshtypje fakti që Samiu, tek *Alfabetarja*, kur përpiket t’i përligjë zgjedhjet e bëra, përdor rregullisht format e shumësit: *muarmë*, *u dhamë*, *i bëmë*, çka nuk na ngjan si shumësi i modestisë. Shih citimin më poshtë.

7 Cituar sipas Xhevat Lloshit, te *Rreth alfabetit të shqipes*, Logos-A, Shkup – Prishtinë – Tiranë, 2008, 166-167.

(ngrënia); *mes-hollë* (meshollë), *i herëpas-hershëm* (i herëpashershëm); *Et-hem* (Ethem), *Mit-hat* (Mithat) etj. Nevoja për mënjanimin e tyre na ka shpënë jo pak herë te zgjidhje drejtshkrimore të sforcuara, të cilat përbëjnë edhe sot e gjithë ditën një shkak për shkeljen e normës.

Samiu nuk i zë në gojë fare shkronjat sllave, për të cilat do të bënin fjalë kundërshtarët e alfabetit të Stambollit, por edhe studiues të mëvonshëm. Neve na duket se te *gj*-ja e variantit të dytë kanonik të këtij alfabeti *g* (i pari ka me këtë vlerë një *ŋ*) më shumë se një shkronjë sllave kokëposhtë⁸, kemi një delta të vogël, të përmbysur. Dhe kjo e fundit, para se të jetë shkronjë sllave, është shkronjë greke. Xhevat Lloshi, duke u mbështetur, sipas nesh, tek i njëjti variant, d.m.th. tek ai më i njohuri, flet për 6 shkronja greke⁹, por neve na dalin 7 sosh dhe konkretisht: *δ*/dh, *ε*/e, *g*/*gj*, *λ*/ll, *η*/nj, *ρ*¹⁰/p dhe *ς*/sh. Te 4 shkronjat e mbetura, *ç*, *đ*, *ѣ* dhe *ѣ* kemi gjegjësisht një c me çedilje, të cilën e njohim mirë, një d të modifikuar, me një vijë të harkuar sipër si strehë, pastaj një x të modifikuar, së cilës i është këputur përgjysmë njëra këmbë dhe i është zgjatur së brendshmi tjetra poshtë, ndërsa në fund një z me çedilje. Për mendimin tonë, varianti më i njohur i alfabetit të Stambollit në radhën e shkronjave të vogla të shtypit nuk ka germa sllave (as glagolitike dhe as cirilike). Ai ka 25 shkronja latine, 4 shkronja latine të modifikuara dhe 7 shkronja greke. Por Samiu na ka thënë një gjysmë të vërtete, ngaqë shkronjat cirilike te ky variant i hasim në radhën e shkronjave të mëdha të shtypit. Këtu shquajmë 25 shkronjat latine, 4 shkronja greke *Γ*/*Gj*, *Λ*/*Ll*, *Π*/*P*, *Θ*/*Th*, 4 shkronja latine të modifikuara *Ç*/*Ç*, *Ѣ*¹¹/*Sh*, *Ѧ*/*Xh*, *Ѧ*/*Zh*, dhe 3 shkronja cirilike *Б*/*Dh*, *Ѣ*/*Ē*¹², *И*/*Nj*. Ndryshe qëndron puna me variantin e parë, tek i cili shkronjat cirilike i gjejmë në të dyja radhët: *Ѣ*/*Ç*, *Ѧ*/*Zh*. Pra, alfabeti i Stambollit (në asnjërin prej dy varianteve të para kanonike) nuk ka 8 shkronja sllave, siç pohon Jup Kastrati¹³, madje, edhe po t'i mblidhnim bashkë të gjitha shkronjat cirilike të të dy varianteve, në të dy radhët, dalin 7, jo 8.

Nga ana tjetër, na duket e udhës të vëmë re që mosmbulimi në çdo rast i shkronjës së vogël me gjegjësen e vet të madhe ose, së paku, me një tjetër të të njëjtit lloj, e ka bërë edhe më hibrid variantin e dytë të alfabetit të Stambollit dhe, pa dyshim, e ka dëmtuar atë. Konkretisht, nëse tek *a* → *A*, *b* → *B*, *c* → *C* kemi mbulim të shkronjave të vogla me gjegjëset e tyre të

8 Shih J. KASTRATI, *Lufta për njësimin e alfabetit shqip në vitet 1878-1905*, në A. BUDA, M. DOMI (eds.), *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, 78.

9 LLOSHI, *Rreth alfabetit të shqipes*, 167.

10 Për ne, një eta e vogël, e kthyer majtas ose djathtas. Si shkronjë greke e mban edhe Domi, *loc cit.*, 38.

11 Për ne, një G e përmbysur. (A. D.).

12 Për ne, një B e përmbysur. (A. D.).

13 KASTRATI, *Lufta për njësimin e alfabetit shqip...*, 78.

mëdha, ndërsa te $\mathfrak{g} \rightarrow \Gamma$, $\mathfrak{p} \rightarrow \Pi$ kemi mbulim të shkronjës së vogël me një të madhe të të njëjtit lloj (të dyja shkronjat e çifteve janë greke), një gjë e tillë nuk ndodh me $\mathfrak{d} \rightarrow \mathfrak{B}$, (ku e para është greke, kurse e dyta cirilike), as me $\mathfrak{e} \rightarrow \mathfrak{A}$, (ku e para është greke, kurse e dyta latine e modifikuar), dhe as me $\mathfrak{d} \rightarrow \Theta$ (ku e para është latine e modifikuar, kurse e dyta greke). Nuk mund t'i lëmë pa përmendur as zgjidhjet e paqëlluara $\varepsilon \rightarrow E$ dhe $e \rightarrow \mathfrak{P}$, në të cilat shkronjat e vogla janë greke e latine, ndërsa të mëdhatë latine dhe sllave. Ngjashmëria mes ε -së dhe E-së nuk mjafton për ta përdorur të dytën si shkronjën e madhe të së parës, prandaj prishja e çiftit $e \rightarrow E$, pavarësisht nga vlera që mund t'u jepet shkronjave që e përbëjnë, na duket diçka e papërligjur, kur inventari për të cilin diskutohet i ka të dyja shkronjat.

Me gjithë bazën e padyshimtë latine, alfabeti i Stambollit nuk i shpëtoi dot një lloj hijeje orientale, e cila e përndjek edhe sot. Nuk është e rastit, fjala vjen, që ai, përveçse në Toskëri, gjeti mbështetje të madhe në Shqipërinë e Mesme e, veçanërisht, te bejlerët dhe myslimanët e Tiranës¹⁴, por nuk u ndoq në Veriperëndim. Faik Konica, me urrejtjen e tij patologjike ndaj Frashërllinjve, e quante «turk-moskov», «të ndyrë në të pamë», që e përdorin «nja 10 zaptieh këmbëqelbur të Toskërisë»¹⁵. Për të ai ishte alfabet «i memurëve dhe i zaptiheve, i harbutëve e i ylefxbive, me hije aziatike, i egër»¹⁶. De Rada e quan alfabet «të përzier me germa sllave, ndoshta me latine e greke»¹⁷.

Ndryshe nga ç'besojmë ne, për shkak të historishkrimit zyrtar dhe ndryshe prej përfytyrimit kolektiv, të përfutur edhe falë prodhimeve të Kinostudios «Shqipëria e Re», rilindësit nuk kanë punuar gjithnjë në ilegalitet, ose «me kokë në torbë». Është fakt i njohur, fjala vjen, që mbledhja themeluese e Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip u mbajt në shtëpinë e Abdyl Frashërit, në Perë, në një nga lagjet më të pasura të Stambollit, dhe «ditën për diell». Po ashtu, dihet se *Alfabetarja e gluhësë shqip* u botua në Stamboll, më 1879, me një tirazh shumë të madh për kohën, 20000 kopje, gjë që s'mund të ndodhte pa miratimin, qoftë edhe zëulët të autoriteteve. Madje, një kopje e saj, me kushtim, iu dhurua edhe sulltan Abdyl-Hamitit II¹⁸. Vetë Samiu shkruan tek *Alfabetarja*: «Të shkruarit e gjuhës shqipe u bë në kohën e mbretit dhe zotit tonë të math, sulltan Abdyl Hamitit të Dytë, që Perëndia i zgjattë jetën dhe i shtoftë ditët! Kështu edhe shqiptarët

14 Shih LLOSHI, *Rreth alfabetit të shqipes*, 169.

15 Cituar sipas Xhevat Lloshit, te *110 vjet më pas, të pathënat e Kongresit të Manastirit*, 3 dhjetor, 2018, <https://www.kultplus.com>.

16 Cituar sipas Xhevat Lloshit, te *110 vjet më pas, të pathënat e Kongresit të Manastirit*.

17 Cituar sipas Rami Memushajt, tek *Alfabeti i Shoqërisë së Stambollit në dritën e shtypit të Rilindjes*.

18 MYFTARI, *Kjo është alfabetarja e gjuhës shqipe...*

zunë të ecin përpara e të ndriçohen me shkronja dhe dituri.»¹⁹ Dhe të mos harrojmë që jemi në vitet e trazuara të Lidhjes së Prizrenit.

Lidhur me këtë argument, Mahir Domi na sjell disa të dhëna interesante. «Këto përpjekje [përpjekjet e shqiptarëve për një alfabet kombëtar – A. D.] në ndonjë moment u duk sikur gjetën një farë mbështetje të kufizuar në disa rrethe qeveritare turke më largpamëse. Për to u bë fjalë edhe në shtyp; u shpresua në ndonjë çast edhe në daljen e ndonjë leje qeveritare. Për formimin e një komisioni për alfabetin e shqipes njoftonte gazeta e Stambollit “Courrier d’Orient” e 2.3.1870, nga e merr edhe August Dozon-i (“Manuel de la langue chkiye ou albanaise”, Paris, 1878, f. 167). E përmend edhe Dhimitër Kamarda në *A Dora d’Istria gli Albanesi*, Livorno, 1870, f. 21, shën. 1: “Annunziavano i giornali fin dal principio del corrente anno 1870, che il governo turco aveva nominato una commissione per fissare un alfabeto ad uso degli schipetar.” Lajme më të plota jep shkrimtari e militanti iluminist i Rilindjes bullgare Petko Slavejkov, – që punoi disa vjet në Shoqërinë Biblike po në atë kohë që punonte edhe Kristoforidhi e, si pasojë, kishte mundësi të ishte mirë i informuar, – në gazetën bullgare “Makedonija”, të datës 27.1.1870 që nxirrte në Stamboll: “Komisioni që kishte qenë ngarkuar të krijonte një alfabet për gjuhën shqipe i dha fund punës së tij; tani nuk pritet veçse dekreti i sulltanit për të futur në përdorim këtë alfabet. Alfabeti i ri është shumë i thjeshtë. Në përpilimin e tij Komisioni u është shmangur anomalive e çrregullimeve që ndeshen në shumë alfabete evropiane.” (Strašimir Dimitrov, *L’Albanie et la Renaissance albanaise dans la presse dirigée par P. R. Slavejkov*, në “Études balkaniques”, VII, 1968, Sofia, f. 204.)²⁰ Këto të dhëna i konfirmon, duke u mbështetur në burime të tjera, edhe Xhevat Lloshi²¹. Ky thekson që komisioni i parë për alfabetin e shqipes është ngritur në nëntor të vitit 1869²². Duke cituar studiuesin turk, Agâh Sırrı Levend-in, Xhevat Lloshi na bën me dije se «shqiptarët, në një takim me ministrin osman të Arsimit, më 1869, kërkuar një alfabet të veçantë për gjuhën shqipe. Komisioni prej tre vetash, i ngritur për këtë qëllim, pas një pune të gjatë hartoi për shqipen një alfabet me germa latine.»²³ Por cilët qenë anëtarët e këtij komisioni trevetësh? Mes tyre Xhevat Lloshi ia del të identifikojë vetëm njërin, Kostandin Kristoforidhin²⁴. Dhe, ç’është më e rëndësishme, çfarë përfaqësonte ky alfabet më i hershëm, në qoftë se ka pasur vërtet një të tillë? Nga sa thotë Levend-i dhe Slavejkov-i, mund të hamendësohet se “alfabeti i 1870-s”

19 Cituar sipas Myzejen Myftarit, te *Kjo është alfabetarja e gjuhës shqipe...*

20 DOMI, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit...*, poshtëshënimi 15, 18-20.

21 Shih LLOSHI, *Rreth alfabetit të shqipes*, 18.

22 *Ivi*.

23 *Ibid.*, 20, poshtëshënimi 5.

24 *Ibid.*, 18.

ishte një sivëlla i atij të vitit 1879, ngaqë ishte me germa latine dhe ngaqë ndiqte parimin “për çdo tingull një shkronjë”, por, tash për tash, kjo është vetëm një hipotezë. Mbetet, gjithsesi, e paqartë se pse shqiptarët, të cilët e paskan pasur gati një alfabet që më 1870, nuk botuan gjësendi me të, por pritën edhe 9 vjet që të themelonin një shoqëri, të hartonin një tjetër alfabet dhe të botonin më në fund *Alfabetaren* e tyre. Nga ana tjetër, dimë se nuk pati ndonjë dekret sulltanor ose “leje qeveritare” as për “alfabetin e vitit 1870” dhe as për atë të vitit 1879, madje, që prej vitit 1898, qeveria osmane e ndaloi me urdhër futjen në Shqipëri të çdo lloj libri të shtypur me alfabetin e Stambollit²⁵.

Në vitin 1908, në Kongresin e Parë të Manastirit, shqiptarët e ditur u thirrën që t’i jepnin bashkësisë së tyre një alfabet të vetëm. Për të shmangur përplasjen, ata iu futën punës së hartimit të një alfabeti *ex novo*, por dështuan. Praktikisht, atyre u duhej të zgjidhnin mes tri alfabeve: atij me bazë latine të Stambollit dhe dy të tjerave thjesht latine, të “Bashkimit” dhe të “Agimit”, ndërkohë që alfabeti turko-arab u rrinte te porta. Për disa arsye, ndër të cilat kreun e vendit e zë, pa dyshim, shmangia e një përçarjeje të madhe, në një kohë që lypsej bashkim, ata formalisht nuk zgjodhën²⁶. Por, sipas Androkli Kostallarit, «është e vërtetë se në të [në Kongresin e Manastirit – A. D.] pranohen me të drejta të barabarta dy alfabe. Dhe jo vetëm kaq. Alfabeti i Stambollit vihet në radhë të parë dhe vetë teksti i Vendimit është shkruar me këtë alfabet. Por megjithkëtë, Kongresi i Manastirit ishte, si të themi, kënga e mjellmës për alfabetin e Stambollit. Ai edhe e pranoi, edhe e mohoi këtë alfabet. E pranoi në mënyrë eksplicite, duke e lënë shprehimisht në fuqi. E mohoi në mënyrë implicite, duke i kundërvënë, me të drejta të barabarta të një alfabeti kombëtar, një alfabet tjetër që përfshinte plot dy të tretat e alfabetit të Stambollit dhe që kishte kundërshtim tij disa epërsi cilësore e praktike.»²⁷

Është me interes të vërehet se për Mahir Domin «në alfabetin thjesht latin u pranuan 6 germa latine me vlerat që kishin në alfabetin e Stambollit:

25 LLOSHI, *110 vjet më pas, të pathënat e Kongresit të Manastirit*.

26 Në tekstin e vendimit të komisionit për çështjen e alfabetit lexojmë: «Pas që u-kënduan verbalet e ditëve t’jera e pas që e pamë se puna që kishim bërë ishte mjaft e madhe, po jo aqë sa të na kënaqte të gjithëve e t’i shërbente si përparimit të gjuhës, si të përhapurit të diturisë ndër ne, të shtyrë edhe nga disa shkaqe të përjashtme, u-këthyem prapa e me pëlqim të të gjithëve u-vendos që të mirret Abeja e Stambollit e me të bashkë edhe Abece fjesht latine, që të mësohen e të përdoren bashkarisht në mest të Shqypëtarëve. Mësimi ndë shkollë do të jetë i shtrënguar e i detyrueshëm për të dyja.» Cituar sipas Mahir Domit, tek *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit...*, në A. BUDA, M. DOMI (eds.), *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, 38.

27 A. KOSTALLARI, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1973, 53.

c, ç, j, q, y, x. Dy alfabetet ndryshonin kështu vetëm në 9 germa: dh/**ḏ**, ë/**ε**, gj/**g**, ll/**λ**²⁸, nj/**η**, sh/**ς**, th/**θ**, zh/**ζ**, xh/**χ**, ndërsa 27 germa i kishin të njëjta.»²⁹

Përqasja e dy alfabeve të miratuara në Kongresin e Manastirit tregon se ai i Stambollit pësoi në këtë Kongres disa ndryshime që e afronin edhe më shumë me alfabetin thjesht latin, ndër të cilat tërheqin vëmendjen ndërkëmbimi i vlerave të **ε**-së me **e**-në, heqja e **η**-së dhe zëvendësimi i saj me **p**-në, përdorimi i dyshkronjëshit **rr** me vlerën e polivibrantes, heqja e shkronjës **χ** dhe zëvendësimi i saj me **χ**, siç pati vënë re edhe Mahir Domi³⁰.

Për sa u takon “epërsive cilësore” të alfabetit thjesht latin që përmend Kostallari, duhet thënë se alfabeti i Manastirit është homogjen, është më i thjeshtë, kurse ai i Stambollit është heterogjen, me disa shkronja të modifikuara³¹ e, për më tepër, ka edhe zgjidhje të paqëlluara. Nga ana tjetër, alfabeti i Manastirit ka më pak grafema, gjithsej 27³², ndërsa ai i Stambollit ka 36. Nuk është e vështirë të kuptohet se të qenët homogjen dhe me më pak grafema do t’i jepte alfabetit të Manastirit edhe “epërsi praktike”, duke e bërë më të lehtë botimin e librave me të, meqë shkronjat latine gjendeshin kudo jashtë Shqipërisë, ndërsa shkronjat e modifikuara të alfabetit të Stambollit siguroheshin me vështirësi dhe kushtonin mjaft. Po ashtu, nuk duhet harruar që “marifeti” i përdorur në Kongres, për t’i bërë vend edhe alfabetit thjesht latin, ishte se me të mund të dërgoheshin lehtë telegrame (shqiptarët patën takuar më në fund telegrafin), kurse me alfabetin e Stambollit, jo.

Por, pavarësisht prej të metave, alfabeti i Stambollit u pati shërbyer shqiptarëve për gati 30 vjet; me të u botuan librat e rilindësve dhe u mësua gjuha shqipe. Kjo, natyrisht, do t’i jepte atij një prestigj më të madh krahasuar me alfabetet e tjera, prestigj që gjithsesi, pak do ta ndihmonte për të mbijetuar. Nga ana tjetër, ndonëse alfabeti i Stambollit gëzonte ende prestigj, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për dalzotësit e tij, në vigjilje dhe pas Kongresit të Manastirit. Ndër ta më zulummadhi qe, pa dyshim, Mithat Frashëri, për të cilin shkronjat e alfabetit të Stambollit «s’kanë asnjë qime të metë, janë të lehta, të bukura, të thjeshta, të mbaruara»³³. Na duket me vend të kujtojmë se ç’shkruan Çajupi në pamfletin e njohur, *Klub’ i Selanikut*.

28 Te ky inventar i Domit mungon shkronja ll/λ. Ne e shtuam, ngaqë besojmë se kemi të bëjmë me një gabim shtypi. (A. D.).

29 DOMI, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit...*, në A. BUDA, M. DOMI (eds.), *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, 38.

30 Ivi.

31 Për ne, me 4 të tilla në radhën e shkronjave të vogla dhe 3 në radhën e shkronjave të mëdha të shtypit, te varianti i dytë kanonik. (A. D.).

32 LLOSHI, *Rreth alfabetit të shqipes*, 78.

33 Cituar sipas Rami Memushajt, tek *Alfabeti i Shoqërisë së Stambollit në dritën e shtypit të Rilindjes*.

«T'u thaftë goja, more beu ynë! Të plastë koka more beu ynë! Të paskan lënë mëntë, more beu ynë! Qënke veshgjatë, more beu ynë! Qënke turk, more beu ynë! Qënke xhonturk, more beu ynë! Ndë Klub të Shqiptarëvet na the si duhet të sillët Turqia që të shpëtojë nga rreziku i sotmë dhe të rrojë përjetë. Pse s'fole një fjalë dhe për Shqipërinë? Pse? Apo s'keshe se ç'të thoshe? Apo t'erth frikë nga xhonturqit, që të dërguan mut-e-sarif³⁴ ndë Seres, që të shaç kaurët? Pse s'tu tha gjuha ndë gojë?...»³⁵

Dihet që këto fjalë i drejtohen Mehdi Frashërit, kushëririt të largët të Mithatit, por tërthorazi e prekin edhe atë, si president i Klubit të Selanikut. Në të vërtetë, Çajupi nuk e lë pa fshikulluar as Mithatin, meqë në të vetmen fjali që vë në gojën e tij – «Prit, pakëzë, më thotë, se kam një ç-çi-çikë punë me bejnë.»³⁶ – nuk ngurron ta vërë në lojë për cenin që kishte, Mithat beut i mbahej goja. E, megjithatë, Mithat Frashëri u zgjodh kryetar i Kongresit, madje, sipas Xhevat Lloshit, ai u paraqit me një ditë vonesë, që të sigurohej se do t'i linin kreun e vendit, që të kishte mundësi të diktonte vullnetin e vet.³⁷

Për fat të keq, në betejat tona *ad hominem* nuk i kemi kursyer as Frashërlinjtë e mëdhenj. Në vitin 1888 gazeta “Shqipëtar”, që botonte në Bukuresht Nikolla Naço, pyeste: «Kur gjithë bota e ndritur shërbejnë me shenja latine, përse neve shqipëtarët të qiarlemi (grindemi – R. M.) në mes tonë për qefin e ca tiranëve?»³⁸ Me sa duket, për artikullshkruesin e “Shqipëtarit”, mes tiranëve paskan qenë edhe Naimi me Samiun, të cilët shkruanin e botonin asokohe me alfabetin e Stambollit.

Vështirësitë praktike që paraqiste botimi i librave me alfabetin e Stambollit mund të ishin kapërcyer me ndihmën e shkronjave me shenja diakritike, siç dëshmon ndonjë prej ndryshimeve që iu bë atij në Kongres, por edhe zgjidhjet që u dhanë për ë-në e për ç-në në alfabetin e Manastirit. Prandaj kufizimi tek ato e thjeshtëzon problemin dhe nuk i ndihmon së vërtetës. Ne besojmë që në braktisjen e alfabetit të Stambollit kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë, ndër të cilët do të veçonim rivalitetin mes tri qarqeve letrar-kulturore, të Jugut, të Veriut dhe të atij arbëresh. Lidhur

34 Fjala në turqishte është *mutasarrıf*, “guvernator”. Në shqipe ka hyrë si mytesarif, me këtë trajtë e ka edhe *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, 1980, që e shënon me kuptimin kryetar i administratës së një sanxhaku në Perandorinë Osmane. Nuk na duket e paqëllimtë përftesa çajupiane *mut-e-sarif*. (A. D.).

35 A. Z. ÇAJUPI, *Klub’ i Selanikut*, në “Antologjia e letërsisë shqipe për shkollat e mesme” (deri më 1939), për klasat IX-X, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1968, 132. Botuar së pari te gazeta “Rrufeja” e Egjiptit, gusht, 1909, që e drejtonte Jani Vruho.

36 *Ibid.*, 131.

37 LLOSHI, 110 vjet më pas, të pathënat e Kongresit të Manastirit.

38 Cituar sipas Rami Memushajt, tek *Alfabeti i Shoqërisë së Stambollit në dritën e shtypit të Rilindjes*.

me këtë është mjaft domethënës pohimi i De Radës që shkruan se nuk do ta përdorte një alfabet «që do ta gjymtonte gjuhën dhe do ta shkatërronte shpirtin muzikor të saj».³⁹ Se në ç'mënyrë do ta gjymtonte shqipen dhe do ta shkatërronte shpirtin e saj muzikor alfabeti i Stambollit, këtë De Rada nuk na e sqaron.

Një tjetër faktor përbën, sipas nesh, dëshira për protagonizëm dhe rivaliteti mes eksponentëve të të njëjtit qark letrar-kulturor. Për këtë le të sjellim ndër mend shkrimet e Konicës ndaj alfabetit të Stambollit dhe atyre që e mbronin atë. Edhe Noli, në faqet e “Albanisë”, në fund të vitit 1908⁴⁰, nën pseudonimin *Pesimisti*, nuk i kursen romuzet për Kongresin e Manastirit, të cilin e quan me tallje, kongres për “një abe të perëndishme”⁴¹. Megjithatë, është fakt se “Dielli” (3 shtator 1909), ndonëse i përmendte kritikën për Kongresin, shprehte besimin se do të mbetej vetëm alfabeti latin dhe, nga numri 3, nisi të përdorte alfabetin e ri⁴², ndërkohë që dy numrat e parë qenë botuar me alfabetin e Stambollit.

Si për të vendosur baraspeshën, në një letër drejtuar një kolegu, menjëherë pas Kongresit të Manastirit, më 05.12.1908, at Gjergj Fishta, delegat dhe kryetar i komisionit të alfabetit në Kongres, shkruante kështu: «Impreparati come eravamo al Congresso ed a sostenere la battaglia contro proprio tutta l'Albania – tutti erano contro il sistema di Bashkimi – credo che non sia un piccolo successo l'esser riuscito a far adottare il nostro sistema con piena disfatta dell'Agimi.»⁴³

Por, mjafton t'i hedhësh një sy alfabetit 34-shkronjesh të “Bashkimit”⁴⁴:

39 Cituar sipas Rami Memushajt, tek *Alfabeti i Shoqërisë së Stambollit në dritën e shtypit të Rilindjes*.

40 LLOSHI, 110 vjet më pas, të pathënat e Kongresit të Manastirit.

41 Ivi.

42 “Dielli” e nisi jetën si gazetë e përvajshme e shoqërisë “Besa-Besën”. Numri i parë doli më 15 shkurt 1909, në Boston. Atë vit u botuan gjithsej 47 numra, nga të cilët 29 të parët (15 shkurt – 15 tetor) u përgatitën nën drejtimin e Fan Nolit. Me numrin 30, i cili doli më 22 tetor 1909, drejtimin e gazetës e mori Faik Konica, i cili u thirr nga Londra enkas për këtë punë; prandaj Xhevat Lloshi ka të drejtë kur thotë se “Diellin” me alfabetin e Manastirit nisi ta botonte Noli.

43 Cituar sipas Mahir Domit, tek *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit...*, në A. BUDA, M. DOMI (eds.), *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, 40, poshtëshënimi 46.

44 Radhën e shkronjave të vogla të shtypit e kemi nxjerrë nga faksimilja e faqes VII të fjalorit të kësaj shoqërie, botuar prej Andreas Dushit, *Kush e hartoi alfabetin e gjuhës shqipe*, <http://www.exlibris>, 23 nëntor, 2020.

a, b, c⁴⁵, ch⁴⁶, d, dh, e⁴⁷, f, g, gh⁴⁸, gn⁴⁹, h, i⁵⁰, k, l, ll, m, n, nn⁵¹, o, p, r, rr, s, sh, t, th, ts⁵², v, u, y, x⁵³, xh⁵⁴, z, ⁵⁵ për ta kuptuar se entuziazmi i fratit të urtë që i pavend. Është e vërtetë se alfabeti i Manastirit i pranoi digramet, ndryshe prej atij të Stambollit që për to përdorte shkronja të modifikuara dhe atij të “Agimit” që në vend të tyre parapëlqente shkronja me shenja diakritike, por, po ashtu është e vërtetë se nga 10 digrame që ka alfabeti i “Bashkimit” ai i Manastirit shtiu në punë, me të njëjtën vlerë, vetëm 5 e, për më tepër, digramet në shkrimin e shqipes nuk i solli “Bashkimi”, çka mund t’i jepte ndokujt të drejtën të pohonte se alfabeti i Manastirit përdori sistemin e tij, ngaqë ato kanë qenë përdorur edhe më parë nga De Rada e të tjerë. Mjaft interesant është, sipas nesh, bilanci që bën Gjon Ujka, nën pseudonimin *Lul Shkurti*, lidhur me ndikimin që pati alfabeti i “Bashkimit” mbi atë të Manastirit. «Tue lënë jashtë germat që i kanë të perbashkëta me të tjerë dy alfabetat, një shqyrtim i këtyne ka me na dëftue se n’alfabetin e sotshëm gjinden vetem pesë germa t’atij të “Bashkimit”, d.m.th. *dh, ll, th, sh* e *rr*. Perkundra janë lënë jashtë prej si dymbëdhjetë germa me vlerë fonetike që këto kishin n’atë alfabet... Në vënd të germave të perjashtueme prej atij të “Bashkimit”, alfabeti i Manastirit mori shtatë prej atij të “Stambollit” e të “Agimit”... e pesë të tjera i shtinë së parit në përdorim.»⁵⁶ Për Mahir Domin, «Alfabeti i Manastirit ka 11 germa të ndryshme nga ai i “Bashkimit” (12 nga i Stambollit, 13 nga i “Agimit”); c/ts, ç/ch, e/é, ë/e, gj/gh, nj/gn, q/c, x/z. xh/zh, z/x, zh/xh. Në të tilla kushte del i pakuptueshëm e i çuditshëm pohimi i atyre që e kanë quajtur atë si alfabet të “Bashkimit”, me pak ndryshime. Aq më pak qëndron mendimi se alfabeti i Manastirit është alfabeti i “Agimit” me pak ndryshime, ose se ai ka dalë nga të përzjerët e alfabeve të “Bashkimit” e të “Agimit” me disa modifikime.»⁵⁷

Përveç këtyre që përmendëm e që janë pjesë e pandashme e natyrës

45 Përdorej për *q*.

46 Përdorej për *ç*.

47 Përdorej edhe me vlerën e *ë*-së.

48 Përdorej për *gj*.

49 Përdorej për *nj*.

50 Përdorej edhe me vlerën e *j*-së.

51 Përdorej për një *n* “të fortë”, si të *ghinnét* (gjinët), *mrênne* (mrenë).

52 Përdorej për *c*.

53 Përdorej për *z*.

54 Përdorej për *zh*.

55 Përdorej për *x*.

56 Cituar sipas Andreas Dushit, *Kush e hartoi alfabetin e gjuhës shqipe*.

57 M. DOMI, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, “Studime filologjike” 4 (1968), 90-91.

njerëzore, kemi edhe një faktor tjetër, i cili lidhet me trysninë që nisën të ushtrojnë, menjëherë pas Kongresit të Parë të Manastirit, turqit e rinj, për t'u imponuar shqiptarëve alfabetin turko-arab. Ky rrezik i radikalizoi qëndrimet dhe e shndërroi alfabetin thjesht latin të Manastirit në një nga emblemat e luftës për shkëputjen përfundimtare nga Perandoria Osmane.

Në 2-3 prill të vitit 1910 u mbajt Kongresi i Dytë i Manastirit. Në historishkrimin tonë ky njihet edhe si *kongresi i rregullimit të alfabetit*. Në tragën e Kongresit të Dibrës (23 korrik 1909) dhe të Kongresit të Elbasanit (2-9 shtator 1909) edhe ky manifestim i zgjimit të vetëdijes kombëtare ndër shqiptarët rikonfirmoi vendosmërinë e tyre për të përdorur vetëm alfabetin e Manastirit, si dhe për të mos pranuar asnjë alfabet tjetër që do t'u imponohej nga jashtë. Megjithëse, sipas programit dhe promemories që dolën nga ky Kongres, në korrik të atij viti (1910), do të mblidhej në Janinë një tjetër, “më i madhi kongres që ishte mbajtur ndonjëherë në trevat shqiptare”, ku lypsej të merrej vendimi përfundimtar për çështjen e alfabetit, mund të thuhet me plot gojën se, në të vërtetë, Kongresi i Dytë i Manastirit ia mbylli edhe formalisht derën alfabetit të Stambollit⁵⁸.

Edhe Mithat Frashëri, që, me kokëngjeshjen tipike shqiptare, vazhdoi ta përdorte alfabetin e Stambollit, edhe pas Shpalljes së Pavarësisë, te “Diturija” e vet, u shtrëngua të hiqte dorë prej tij dhe të përdorte alfabetin thjesht latin të Manastirit, që nga numri i qershorit të vitit 1916, i botuar në Bukuresht, pa dhënë asnjë shpjegim.

58 Për arsye të kuptueshme, *kongresi i Janinës*, i paralajmëruar që në Kongresin e Parë të Manastirit, nuk u mbajt.